



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 309/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Vedat Poterqoi- Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani-Referuese, dhe Agon Ramadani-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE "PE-VLA-KU" Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Tri Shkollave Të Reja, Sigurimi i Mirëmbajtjes dhe Ofrimi i Shërbimeve në Komunën e Prishtinës, Republika e Kosovës" me Nr. prok. 616-20-3914-5-1-2, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues, me datën 18.11.2022 mori:

V E N D I M

1. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik OE "PE-VLA-KU" ShPK e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 05.08.2022, numër protokollit 309/2022, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Tri Shkollave Të Reja, Sigurimi i Mirëmbajtjes dhe Ofrimi i Shërbimeve në Komunën e Prishtinës, Republika e Kosovës" me numër prokurimi 616-20-3914-5-1-2, iniciuar nga Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues.
2. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës për sigurim të ankesës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP. Kurse, ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimin të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.07.2020, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, kishte publikuar Njoftimin për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar (numër, datë dhe emërtim) si në hyrje të këtij Vendimi, përderisa hapja publike e ofertave ishte bërë me 06.04.2021.

Me 15.04.2021, AK (me të dhëna si më sipër) kishte publikuar Vendimin sipas të cilit Grupi i Operatorëve Ekonomik “ABC” “Beni Dona gr” “Beni Dona Plast & Olti Plast, është rekomanduar për kontratë me vlerën e ofertës 13,500.386.48 €.

Me 19.04.2021, OE “PE-VLA-KU” SHPK ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim, e cila ishte refuzuar me Vendimin e AK të datës 22.04.2021, kurse Njoftimi, respektivisht Vendimi i cituar si më sipër i AK për dhënie të Kontratës, është vërtetuar.

Me 29.04.2021, OE në rastin konkret, Kundër Vendimit të cituar si më sipër kishte parashtruar Ankesë në OSHP, numër protokolli 360/2021.

Me 07.05.2021, OSHP kishte angazhuar ekspertin shqyrtues që sipas autorizimeve të tija, të parapara me nenin 113 dhe 114 të LPP, ta bëjë vlerësimin paraprak të dosjes dhe pretendimeve ankimore, i cili kishte rekomanduar se: a) pretendimet ankimore të OE “PE-VLA-KU” SHPK, ishin konsideruar pjesërisht si të bazuara. Kurse Njoftimi, cituar si më sipër) mbi Vendimin e AK për dhënie të kontratës ka rekomanduar të mbetet në fuqi. (Ekspertiza e datës 19.05.2021, Nr. Protokolli 360/21).

Duke theksuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit, nuk kishte Bord nga data 01.04.2021, deri me 23.06.2022, kur Kuvendi i Kosovës ka emëruar Bordin e këtij Institucioni, i cili me 12.07.2022, ka marrë Vendimin Nr. 360/21, sipas të cilit ankesa e OE (së bashku me një numër të konsiderueshëm të ankesa) është hedhur si e pas-afatshme, meqenëse ishin tejkaluara të gjitha afatet ligjore për shqyrtimin e tyre.

Me 26.07.2022, Komuna e Prishtinës në cilësinë e AK ka publikuar Njoftimin për Dhënie të kontratës duke rekomanduar sërish për kontratë OE Grupi i Operatorëve Ekonomik “ABC” “Beni Dona gr” “Beni Dona Plast & Olti .

Me 27.07.2022, OE “PE-VLA-KU” SHPK ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim, kurse AK ka publikuar si shtojcë të dokumenteve Ekspertizën e lëshuar me numër rendor 360/21, të datës 19.05.2021.

Me 05.08.2022 OE ankues “PE-VLA-KU” Sh.p.k, ka parashtruar ankesë (Nr. protokolli: 309/22), kundër njoftimit të cituar si më sipër për dhënie të kontratës.

Me 23.09.2022, OSHP kishte angazhuar ekspertin shqyrtues që sipas nenit 113 dhe 114 të LPP, ta bëjë vlerësimin paraprak të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Në këtë rast, sipas Raportit të ekspertit (Nr.309/22), pretendimet ankimore të OE “PE-VLA-KU” SHPK, janë konsideruar pjesërisht si të bazuara, kurse njoftimi për dhënie të kontratës ka rekomanduar të mbetet në fuqi.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP, konsideron se Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtojë ankesë në OSHP. Meqë OE kanë ushtruar kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen njëherësh dhe nenit 108/A, meqë sipas paragrafit 1, të nenit 109, parashihet se, cituar: “Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji”. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara lidhur me nenin 111, dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP. Më tej, duke vepruar konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP, Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Sikurse dhe është shpjeguar në pjesën hyrëse të këtij arsyetimi (shih: *Faktet dhe rrethanat procedurale*), autoriteti kontraktues me datën 15.04.2021, kishte publikuar për këtë aktivitet të prokurimit, njoftimin mbi vendimin (B58), sipas të cilit është rekomanduar për kontratë njëri prej tenderueseve, shpjeguar si më sipër. Kundër këtij vendimi, OE “PE-VLA-KU” SHPK, nga cilësia e tij si palë e pakënaqur, ka parashtruar ankesë në OSHP. Mirëpo, në bazë të dispozitave ligjore 114, 115 dhe 117 të LPP, parashihet se afati i përgjithshëm për nxjerrjen e vendimit përfundimtar është 34 ditë, duke e përfshirë në raste të caktuara dhe afatin shtesë për njëzet (20) ditë, nëse OSHP e konsideron shtyrjen e afatit në një rast të tillë si të domosdoshme për shkak të natyrës komplekse të lëndës. Por lidhur me çështjen në rastin (krahas një mori lëndësh tjera) Bordi i OSHP-së, bazuar në kontekstin e përgjithshëm të dispozitave ligjore të LPP lidhur me afatet, kishte konstatuar se në fakt ishin tejkaluar të gjitha afatet ligjore, përtej të cilave Bordi nuk kishte më ndonjë alternativë dhe kompetencë që afatet ti zgjasë, në mënyrë që të vendos për Lëndët/ankesat e grumbulluar dhe të pazgjidhura, përfshirë dhe ankesën e parashtruesit në rastin konkret.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara si më sipër, Bordi (i emëruar me 23.06.2022), mori Vendimin Nr. 360/21, datë 12.07.2022, sipas të cilit ankesa e OE (së bashku me një numër të konsiderueshëm të ankesa) është hedhur si e pas-afatshme, për shkakun se ishin tejkaluar të gjitha afatet ligjore për shqyrtimin e tyre.

Duke marrë parasysh mungesën e organit epror të OSHP, gjatë periudhës kohore të shpjeguar si më sipër, i cili i ushtron autorizimet nga cilësia e tij si organ i shkallës së dytë, Bordi ka konsideruar se palët megjithatë kanë të drejtë për shfrytëzimit të mjetit juridik (padsisë), për realizimin e pretendimeve të tyre, nga Gjykata kompetente. Për më tepër, palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë bashkë me padi edhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit sipas nenit 22 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, pranë Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative. Në fakt një situatë e tillë, është parashikuar dhe me nenin 124, të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, sipas të cilit pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky

veprim apo mosveprim. Dhe se, pala ka të drejtë të ushtroj drejtpërdrejtë padi në gjykatë, nëse nuk ekziston organi epror, siç parashihet me paragrafin 6.1, të nenit 124, të këtij Ligji.

Kështu, sikurse është shpjeguar si më sipër, AK me 15.04.2021, ka publikuar Vendimin mbi Njoftimin për dhënie të kontratës (B58), ndaj të cilit operatori ekonomik ankues ka parashtruar ankesë në OSHP e cila është hedhur si të jashtë afatshme por me vendimin e cituar pala është udhëzuar që me kërkesëpadi t'i drejtohen Gjykatës Themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit. Pas Vendimit të cituar si më sipër të OSHP, AK nuk ka publikuar më pas ndonjë lloj vendimi (ndaj të cilit palët mund të paraqesin ankesë) por drejtpërdrejtë ka publikuar dy (2) herë radhazi Njoftimin për dhënie të kontratës (B08), ndaj të cilit Legjislacioni nuk parasheh të drejtën e ushtrimit të ankesës. Lidhur me këtë në nenin 10 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 43.3, të RRUOPP, parashihet se aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës.

Po ashtu, edhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, në pajtim me autorizimet e parapara në kuptim të nenit 87, të LPP, ka shpjeguar se sipas nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit të cituar "*pas publikimit të Njoftimit për dhënie të kontratës, AK nënshkruan kontratën*" (shih në faqen zyrtare të pyetjet e shpeshta, Pyetja nr. 61, datë 03.08.2018).

- Përfundim -

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Prishtinë;

1x1 OE- "PE-VLA-KU" Sh.p.k;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.